



# KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

- BE QENDRA E KUVENDIT-

## BE LAJME

shtator viti 2014  
BEQ-numër 3/2014



### PËRBËRJE E KOMISIONIT EVROPIAN



Kryetari i ri i zgjedhur i Komisionit Evropian *Zhan Klod Junker*, më 10 dhjetor këtë vit e prezantoi ekipin e tij që duhet të jetë i hapur për reforma dhe i gatshëm të ballafaqohet me sfidat politike për ekonomi të suksesshme vende stabile të punës, mbrojtje më të madhe sociale, siguri energjetike, kufij më të sigurt dhe mundësi digjitale.

Kryetari i ri i Komisionit dorëzoi listën e komisarëve të caktuar në Këshillin e BE-së, kurse lista finale është miratuar në marrëveshje të përbashkët me Këshillin, më 5 shtator këtë vit. Pajtim për përbërjen e Kolegjit të Komisarëve, në tërësi duhet të jep Parlamenti Evropian, duke përfshirë edhe kryetarin e Komisionit Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian për punë të jashtme dhe politikë të mbrojtjes. Në pajtim me nenin 118 të Rregullores së Parlamentit Evropian, komisarët e caktuar do të dëgjojnë në komitetet relevante të PE. Pas pajtimit të fituar nga Parlamenti Evropian, Komisioni Evropian caktohet nga ana e Këshillit Evropian, në pajtim me nenin 17 (7) të Marrëveshjes për BE.

Përfaqësuesin e lartë të Bashkimit për punë të jashtme dhe politikë të mbrojtjes *Frederika Mogerini*, e cila njëkohësisht do të ushtrojë edhe funksionin e nënkryetarit të Komisionit. Në Komisionin, Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit për punë të jashtme dhe politikë të mbrojtjes do të jetë përgjegjës për projektin “Aktor i fuqishëm global”, që do të menaxhojë dhe koordinojë punën e komisarëve për politikë evropiane fqinjësore, negociata për zgjerim, tregti, bashkëpunim dhe zhvillim ndërkombëtar, ndihmë humanitare dhe menaxhim me krizat.

Një prej prioriteteve kryesore të Komisionit do të jetë fuqizimi i konkurrencës evropiane, stimulimit të investimeve dhe krijimit të vendeve të punës.

Për nënkryetari i obliguar për vende të punës, rritje, investime dhe konkurrencë është caktuar *Jurki Katainen* i cili do të jetë përgjegjës për menaxhim, koordinim dhe zbatim të pakos së rritjes, vendeve të punës dhe investimeve i cili në 3 vitet e ardhshme duhet të sigurojë 300 miliard euro si investim shtesë publik dhe privat në ekonominë reale. Poashtu do të duhet të menaxhojë dhe koordinojë punën e disa komisarëve prej më shumë resorëve: për çështje ekonomike dhe monetare, politikë rajonale, punë sociale, treg të brendshëm, sipërmarrësi, industri, ekonomi digjitale, aksione klimaterike, energjetikë, transport dhe tjera.

#### Përmbajtje e lajmeve:

Përbërje e re e Komisionit Evropian	1-3
Kandidatët për komisarë pranë komiteteve në PE	4
Marrëveshja për Asociim të Ukrainës me BE-në e Ratifikuar	4
Pas referendimit Skotlanda pret autonomi më të madhe	5
Lidhje transporti të Evropës	6
Java Evropiane e mobilitetit 2014	6
10 vite pas aderimit të Polonisë në BE	6
Javë Evropiane e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme	7
Interesi i zmadhuar në nivel rekord për Programin Erasmus	7
Mbrojtje më të madhe e të dhënave personale	8
Republika e Maqedonisë u anëtarësuar në BE Programin COSME	9
BE kalendar tetor 2014	9

Propozimi për përbërjen e re të Komisionit Evropian përfshin: 5 kryeministra të mëparshëm, 4 zëvendës kryeministra të mëparshëm, 19 ministra të mëparshëm, 7 komisar të mëparshëm dhe 8 anëtar të mëparshëm të Parlamentit Evropian. Në Komisionin Evropian të ri femrat do të përfaqësohen me 33% (9 pozita), kurse meshkujt me 66% (19 pozita). Në përbërjen e Komisionit, 14 prej anëtarëve janë të Partisë Popullore Evropiane, 8 nga Aleanca Progressive e socialistëve dhe demokratëve, 5 nga Aleanca e liberalëve dhe demokratëve për Evropën dhe 1 nga Partia e Konservatorëve dhe Reformistëve Evropian.

Komisioni Evropian i ri do të ketë 7 nënkryetarë, prej të cilëve tre vende janë paraparë për femra, duke përfshirë edhe

## PËRBËRJE E KOMISIONIT EVROPIAN

Për nënkryetar të Komisionit të angazhuar për Tregun e vetëm digjital është caktuar *Andrus Ansip* i cili do të koordinojë punën e komisarëve për ekonomi dhe shoqëri digjitale, treg të brendshëm, industri, drejtësi, konsumator, barazi gjinore, bujqësi, zhvillim rural, politikë rajonale, tatime dhe doganë. Nëpërmjet krijimit të Tregut të vetëm digjital, Bashkimi do të mund të gjenerojë deri më 250 miliard euro rritje plotësuese gjatë kohës së mandatit të Komisionit të ri, që do të reflektohet në krijimin e vendeve të reja të punës veçanërisht për personat e ri si dhe shoqëri dinamike të bazuar në dituri.

Në planet e Junker është përfshirë reforma dhe riorganizimi i Politikës Energjetike Evropiane në Bashkim Energjetik Evropian të ri. Për nënkryetar përgjegjës për bashkim energjetik është caktuar *Alenka Bratusek*. Nëpërmjet llojshmërisë së burimeve energjetike dhe reduktimit të varshmërisë së lartë energjetike të disa shteteve-anëtare, Bashkimi do të mund të jetë më i pavarur. Me rritjen e pjesëmarrjes në burimet e rigjenerueshme të energjisë dhe efikasitetit energjetik do të krijohen vende të reja të punës dhe do të zvogëlohen shpenzimet.

Për nënkryetar të Komisionit, i angazhuar për euron dhe dialogun social është caktuar *Valdis Dombrovskis*, i cili do të jetë përgjegjës për përcjelljen e Semestrit Ekonomik Evropian dhe për koordinimin dhe zbatimin e iniciativave të konvergencës së politikave ekonomike, fiskale dhe të punës. Me qëllim të ruhet euro-ja, Komisioni do të vazhdojë me reformat ekonomike të shoqëruara me rrjetet sociale dhe dialogun e vazhdueshëm me partnerët evropian social dhe përfaqësuesit e biznesit dhe sindikatës.

Për pozitën nënkryetar i parë i Komisionit përgjegjës për rregullore më të mirë, marrëdhënie ndërinstitucionale, sundim i të drejtës dhe Kartës për të drejta fundamentale, është caktuar *Franc Timermans*. Nënkryetari i parë i Komisionit do të punojë bashkërisht me komisarin përgjegjës për drejtësi, konsumator dhe mundësi të barabarta dhe me komisarin për imigracion dhe punë të brendshme, dhe do të jetë i obliguar për mbikëqyrjen e marrëdhënieve të Komisionit Evropian me parlamentet nacionale, si dhe institucione tjera evropiane.

Me qëllim të sigurohet që shpërndarja e resurseve është në pajtim me prioritetet e caktuara të Komisionit si dhe të arrihet efikasitet maksimal, instalohet pozita nënkryetar për buxhet dhe nënkryetar për buxhet dhe resurse njerëzore. Për këtë resor përgjegjës do të jetë *Kristalina Georgieva*, do të bashkëpunojë me gjithë komisarët e vet, do të duhet të futet modernizim i administratës publike evropiane, duke përfshirë edhe përdorim më të madhe të teknologjive digjitale.

Për komisar për politikë fqinjësore evropiane dhe negociata për zgjerim është caktuar *Johanes Han*, i cili do të jetë përgjegjës për përforcimin e politikës fqinjësore, por gjithashtu edhe për negociatat rrjedhëse për zgjerim.

[http://ec.europa.eu/news/eu\\_explained/140910\\_en.htm](http://ec.europa.eu/news/eu_explained/140910_en.htm)





<http://www.europarl.europa.eu/>

**«...BE duhet të pushojë nga zgjerimi me qëllim të konsolidohet ajo që është arritur te 28 shtetet-anëtare... Negociatat të cilat janë në rrjedhë do të vazhdojnë, dhe veçanërisht Ballkani perëndimor do të duhet të ruajë perspektivë evropiane, por zgjerimi nuk pritet në 5 vitet e ardhshme...»**

*Pjesë e fjalimit të Juncker pranë eurodeputetëve dhe prezantimit të udhëzimeve politike në seancën e PE, më 15 qershor 2014.*

Zhan Klod Juncker është një prej politikanëve evropian me përvojën më të madhe. I lindur më vitin 1954, është anëtarësuar në Partinë Krishtere Sociale popullore të Luksemburgut më vitin 1974. Në periudhën 1995-2013 ka ushtruar funksionin kryeministër i Luksemburgut. Prej 2005-2013 ka qenë kryetar i Eurogrupës. Juncker ka pasur rol vendimmarrës në përgatitjet për nënshkrimin e Marrëveshjes së Mastihtit me të cilën në vitin 1992 është themeluar BE.

Gjatë kryesisë në Luksemburg me Këshillin e BE-së në gjysmën e dytë të vitit 1997, si kryeministër, Juncker filloi luftën kundër papunësisë në BR, kurse gjatë kryesimit të sërishëm me BE-në më vitin 2005, ka vendosur reformën për Paktin për stabilitet dhe rritje.

Për kontributin në BE të Juncker-it i janë ndarë shpërblime të shumta, duke përfshirë edhe shpërblimin prestigjioz *Charlemagne Prize 2006*.

Më 7 mars 2014, në kongresin zgjedhor të mbajtur në Dablin, Irlandën Juncker ka qenë i zgjedhur për kandidat i Partisë Popullore të Evropës, për kryetar të Komisionit Evropian.

[http://ec.europa.eu/about/juncker-commission/biography/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/about/juncker-commission/biography/index_en.htm)

## STRUKTURA E RE E KOMISIONIT EVROPIAN

The screenshot shows a web browser window with the URL [ec.europa.eu/about/juncker-commission/structure/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/about/juncker-commission/structure/index_en.htm). The page content is titled "The new structure of the Juncker Commission" and displays a hierarchical organizational chart. At the top is the President, Jean-Claude Juncker. Below him are six Vice-Presidents, each with a specific portfolio: Frans Timmermans (First Vice-President, Policy Planning, Inter-Institutional Relations, Rule of Law & Charter of Fundamental Rights), Kiriakos Giannouidis (Budget & Human Resources), Alenka Bratušek (Energy Union), Jyrki Katainen (JAG, Growth, Investment & Competitiveness), Valdis Dombrovskis (The Euro & Social Dialogue), and Andrus Ansip (Digital Single Market). Below the Vice-Presidents are 19 Commissioners, each with their name and portfolio: Věra Jourová (Justice, Consumers & Gender Equality), Günther Oettinger (Digital Economy & Society), Pierre Moscovici (Economic and Financial Affairs, Taxation and Customs), Marianne Thyssen (Employment, Social Affairs, Skills & Labour Mobility), Corina Creţu (Regional Policy), Johannes Hahn (European Neighbourhood Policy & Enlargement Negotiations), Dimitris Avramopoulos (Migration & Home Affairs), Vytis Andriukaitis (Health & Food Safety), Jonathan Hill (Financial Stability, Financial Services & Capital Markets Union), Elzbieta Bierkowska (Internal Market, Industry, Entrepreneurship & SMEs), Miguel Arias Cañete (Climate Action & Energy), Neven Mimica (International Cooperation & Development), Margrethe Vestager (Competition), Maroš Šefčovič (Transport & Space), Cecilia Malmström (Trade), Karmenu Vella (Environment, Maritime Affairs & Fisheries), Tibor Navrátil (Education, Culture, Youth & Citizenship), Carlos Moedas (Research, Science & Innovation), Phil Hogan (Agriculture & Rural Development), and Christos Stylianides (Humanitarian Aid & Crisis Management). A note at the bottom right states: "The ADOP may ask this Commissioner (and other Commissioners) to deputise for her in areas related to Commission competence."

## KANDIDATËT PRË KOMISAR PRANË KOMITETEVE NË PARLAMENTIN EVROPIAN



Në Parlamentin Evropian, komitetet dhe grupet politike ka përgatitje për dëgjim publik të kandidatëve për komisar të përbërjes së re të Komisionit Evropian, që do të mbahet prej 29 shtatorit deri më 7 tetor këtë vit.

Kontrollimi i profesionalizmit dhe aftësisë së kandidatëve për komisar do të zgjatë 3 orë me transmetim të drejtpërdrejtë në ueb faqen e Parlamentit Evropian. Paraprakisht, çdo komitet nga PE parashtron tre pyetje me shkrim për kandidatin për komisar nga fusha përkatëse e kompetencës, me mundësi të parashtrorjës 2 pyetje shtesë për komisarët të cilat tërthorazi janë në lidhje me aktivitetin ligjvënës të komiteteve.

Eurodeputetët janë të interesuar dhe presin përgjigje veçanërisht për strukturën e re të Komisionit Evropian, si në praktikë do të zhvillohet koordinimi i punës ndërmjet nënkryetarëve të Komisionit dhe komisarëve. Kjo duke pasur parasysh përputhshmërinë e portofolave dhe rishpërndarjen e resorëve ndërmjet direktorateve politike në Komisionin.

Në fokusin e interesit të eurodeputetëve janë çështjet për papunësinë, të drejtat për mbrojtje sociale, ligjet specifike të cilat do t'i propozojnë komisarët gjatë mandatit, revizioni i direktivës për orarin e punës dhe tjera, për të cilat komisarët do të duhet të përgjigjen me shkrim para se të fillojnë seancat e dëgjimit në komitetet përkatëse të PE.

Për 9 tetor është planifikuar seancë e veçantë për strukturën e re të Komisionit Evropian, që duhet të mbahet gjatë konferencës së kryetarëve në të cilën sipas rregullit kanë të drejtë të marrin pjesë kryetari i Parlamentit Evropian dhe kryetarët e grupeve politike. Pritet që Parlamenti Evropian në seancë plenare më 22 tetor të miratojë përbërjen e Komisionit Evropian të ri.

<http://www.elections2014.eu/en/news-room>

<http://www.euractiv.com/sections/eu-priorities-2020/commissioner-designate-hearings->

<http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/>

## MARRËVESHJA E RATIFIKUAR PËR ASOCIIM TË UKRAINËS ME BASHKIMIN EVROPIAN



*«Ky është moment historik. Dy parlamentet vendosën të votojnë lirshëm në të njëjtën kohë për këtë marrëveshje. Kjo është demokraci e lirë, e kundërta e demokracisë së menaxhuar. Parlamenti Evropian gjithmonë ka qenë në mbrojtje të integritetit territorial dhe sovranitetit të Ukrainës dhe ashtu do të vazhdojë edhe në të ardhmen " .....pjesë e fjalimit të kryetarit të PE Martin Shulc në Strazbur»*

Më 16 shtator këtë vit, Parlamenti Evropian dhe Parlamenti i Ukrainës kanë ratifikuar Marrëveshjen për asociim të Ukrainës me BE-në.

Për Evropianët kjo marrëveshje është historike, kurse për Kiev hap i parë i aderimit në Bashkimi. Integrimi ekonomik, përkatësisht pjesa e marrëveshjes që ka të bëjë me krijimin e zonës së tregtisë së lirë është prolonguar deri më 1 janar 2016, me kërkesë të Ukrainës, duke pasur parasysh gjendjen e vështirë ekonomike të vendit.

Marrëveshja për asociim të Ukrainës me BE-në siguron korvizë për bashkëpunim politik dhe ekonomik, veçanërisht në fushën e energjetikës, jurisprudencës dhe politikës së jashtme. Për tu aplikuar marrëveshja duhet të ratifikohet nga gjitha shtetet-anëtare të Bashkimit, për çka nevojitet kohë. Me nënshkrimin e marrëveshjes Ukraina është

obliguar të respektojë sundimin e të drejtës dhe luftën kundër korrupsionit.

Poashtu, Parlamenti i Ukrainës më 16 shtator miratoi ligj me të cilin parashihet autonomi më e madhe dhe zgjedhje për fushat e pjesës lindore të shtetit, si dhe ligj me të cilin garantohet amnisti me kusht të luftëtarëve të cilët marrin pjesë në konfliktet. Ligji për statusin special të zonave të Donjeck dhe Lugansk parashihet në rajonet të themelohet qeveri e përkohshme autonome për 3 vite. Parashihet zgjedhjet në Ukrainën lindore të mbahen më 7 dhjetor këtë vit.

<http://www.euractiv.com/>  
<http://www.europarl.europa.eu/news/en/news-room/content/20140915IPR62504/html/European-Parliament-ratifies-EU-Ukraine-Association-Agreement>

## PAS REFERENDUMIT SKOTLANDA PRET AUTONOMI MË TË MADHE

Në referendumin në Skotlandë që u mbajt më 18 shtator këtë vit, kanë votuar 84,6% të votuesve, prej të cilëve kundër ishin 55,3% ose mbi 2 milion votues, derisa për pavarësi votuan 44,7%. Për triumf të referendumit ishte e nevojshme njëra prej dy anëve të jetë mbi 1.825.826 vota.

Kryeministri i Skotlandës Aleks Samond pas pranimit të pavarësisë, menjëherë përkujtoi në premtimin për transferimin e kompetencave më të mëdha në Skotlandë, që është dhënë nga partitë udhëheqëse britaneze – konservativët dhe demokratët liberal (në pozitë) dhe laburistët (në opozitë). Samond publikoi se do të tërhiqet nga funksioni ministër i parë i Skotlandës dhe dha dorëheqje si lider i Partisë Nacionale Skotlandeze.

Epilogu i referendumit paraqet fitore për Kryeministrin e Britanisë Kameron i cili personalisht është angazhuar në fushatën. Numri i madh i votave për pavarësi të Skotlandës si dhe përcjellja me vëmendje e referendumit nga rajonet tjera britaneze, imponon nevojën për decentralizim më të madh të vendit. Kameron, deklaroi që do të plotësohet premtimi që është dhënë për transferim të kompetencave në pushtetin rajonal të Skotlandës dhe lajmëroi masa të ngjashme edhe për Anglinë, Uellshin dhe Irlandën Veriore. Skotlandës duhet t'i jepet autorizim më i madh në fushën e politikës fiskale, shpenzimit të buxhetit, detyrimeve sociale, mbrojtjes sociale. Pritet që planet të jenë

të përgatitura deri më nëntor këtë vit, kurse propozim-ligjet deri më janar të këtij viti. Prapë se prapë, afatet e caktuara janë të shkurtra duke pasur parasysh se bëhet fjalë për ligje të ndërlikuara kushtetuese të cilat duhet të shqyrtohen në dy dhomat e Parlamentit Britanik.

Rezultati nga referendumi është përshëndetur nga Bashkimi Evropian si vendim pozitiv për BE-në. Kryetari i Komisionit Evropian, Baroso premtoi se Komisioni do të vazhdojë me dialogun konstruktiv me Qeverinë e Skotlandës, në fushat të cilat janë të rëndësishme për ardhmërinë e shtetit: rritja, punësimi, ndryshimet klimaterike, energjetika, përmirësimi i legjislacionit.

Në Spanjë rezultati nga referendumi është pritur me lehtësim duke pasur parasysh se shteti ballafaqohet me kërkesën për mbajtje të referendumit për pavarësi të Katalonjës, më 9 nëntor këtë vit. Kushtetuta e Spanjës nuk lejon organizim të referendumit i cili nuk i përfshin gjithë qytetarët e vendit. Sipas mendimeve të ekspertëve, nëse mbahet referendum, Gjykata Kushtetuese mund t'i shpall rezultatet si jolegale.



**«Skotlandës duhet t'ç'i jepet autorizim më i madh në fushën e politikës fiskale, shpenzimit të buxhetit, detyrimeve sociale, mbrojtjes sociale.»**




Në Bashkimin Evropian është duke u zhvilluar debat i gjerë për atë çka do të ndodh në periudhën që vijon, Poashtu edhe për argumentimet juridike çka nëse Skotlanda do të votonte për pavarësi. Udhëheqësit e BE-së referohen në Marrëveshjen për BE-në, por në dispozita të ndryshme nga e njëjta.

Sipas mendimit të Baroso të cilin e ndan edhe trashëgimtari i tij Zhan Klod Juncker, si shtet i ri Skotlanda do të kishte ngelur jashtë BE-së dhe do të duhej të parashtrojë kërkesë për anëtarësim. Aderimi i Skotlandës në BE do të duhet të miratohet unanimisht, por janë të mundshme veto nga Spanja, Belgjika, Italia ose shtete-anëtare

tjera. Një prej dallimeve themelore juridike ndërmjet qëndrimeve të Komisionit Evropian dhe Qeverisë së Skotlandës është cila pjesë e Marrëveshjes për BE-në është aplikueshme në rastin e pavarësisë së Skotlandës. Komisioni Evropian insiston në nenin 49 me të cilin rregullohet hyrja e shteteve-anëtare të reja, kurse Qeveria Skotlandeze thirret në nenin 48 sipas të cilit shtetet-anëtare mund t'i modifikojnë marrëdhëniet e tyre.

Ndërmjet dy qëndrimeve të kundërta për anëtarësi në BE të Skotlandës së pavarur ekziston "hapësirë juridike e pahulumtuar" dhe tani më mbahen debate për çështje kushtetuese.

## LIDHJE TRANSPORTI TË EVROPËS



<http://ec.europa.eu/transport/>

### Korridoret:

1. Korridori Baltik-Adriatik
2. Korridori Deti verior-Baltiku
3. Korridori Mesdhetar
4. Korridori Orient-Lindja Mesdhetare
5. Korridori Skandinavik-Mesdhetar
6. Korridori Rajna-Alpe
7. Korridori Atlantik
8. Korridori Deti verior-Mesdhetar
9. Korridori Rajna-Dunav

Komisioni Evropian ftoi shtetet-anëtare të BE-së të propozojnë projekte për shfrytëzimin e 11,9 miliard euro për avancimin e lidhjeve evropiane në fushën e transportit. Mjetet prej BE-së do të shfrytëzohen për projekte në 9 korridore kryesore transportuese të cilat do të formojnë rrjetin evropian transportues. Me realizimin e projekteve do avancohet lidhja lindje-perëndim dhe do të përmirësohen aktivitetet ndërkufitare të kompanive dhe qytetarëve të BE-së. Thirrja për shfrytëzimin e shumës më të madhe deri tani të mjeteve evropiane të BE-së të dedikuara për infrastrukturë transportuese është publikuar më 11 shtator këtë vit dhe do të zgjat deri më 26 shkurt të vitit 2015 deri kur shtetet-anëtare do të duhet t'i parashtrajnë ofertat. Do të zgjidhen projektet më konkurrenente në suazat e 9 korridoreve.

Vlerësimet e BE-së janë që deri në mes

të shekullit transporti i ngarkesave në Evropë do të rritet për 80%, kurse në transportin e udhëtarëve për mbi 50%. Mjetet evropiane për transport për periudhën 2014-2020, në krahasim me buxhetin e mëparshëm janë zmadhuar konsiderueshëm, në shumë prej 26 miliard euro.

Rrjeti i ri transportues do të themelohet deri më vitin 2030 dhe do të lidh 94 porte kryesore evropiane me hekurudhë dhe rrugë si dhe 38 aeroporte kryesore me hekurudhat e qyteteve të mëdha. Do të rikonstruktohen edhe 15.000 kilometra të vijave hekurudhore dhe 35 projekte tejkufitare për zvogëlimin e stërngarkimit të transportit. Gjithë 9 korridoret do të përfshijnë 3 lloje transporti, 3 shtete-anëtare dhe 2 seksione tejkufitare.

[http://ec.europa.eu/transport/themes/infrastructure/news/corridors\\_en.htm](http://ec.europa.eu/transport/themes/infrastructure/news/corridors_en.htm)

## JAVË EVROPIANE E MOBILITETIT 2014



[www.mobilityweek.eu/](http://www.mobilityweek.eu/)



Prej 16-22 shtator në Bashkimin Evropian është shënuar Java Evropiane e mobilitetit me moton “Rrugët tona, zgjedhja jonë” promovuar nga Komisioni Evropian në bashkëpunim me qeveritë nacionale. Fushata u mbajt për herën e 14, dhe kishte për qëllim inkurajimin e qytetarëve të shfrytëzojnë mjete të ndryshme për transport si zëvendësim të automjeteve. Fushata ka paraqitur javë për biçikletistët, këmbësorët, rolerë, skejtboard, të gjithë pjesëmarrësve në komunikacionin të cilët nuk ndotin mjedisin jetësor. Që nga viti 1998 në Francë është shënuar “Dita në qytet pa automjetin tim!”, kurse sukcesi i kësaj iniciative ka sjell në promovimin e Javës Evropiane të Mobilitetit, më vitin 2002.

Java Evropiane e mobilitetit duhet të stimulojë debat publik për përmirësimin e mjedisëve urbane në dobi të mjedisit jetësor dhe cilësisë së jetës së njeriut. Komisioni Evropian e përkrah javën Evropiane të mobilitetit me rreth 300.000 euro në nivel vjetor, rajoni fitues ose pushteti lokal fitojnë shpërblim prej 10.000 euro. Më 24 mars këtë vit në Bruksel është ndarë shpërblimi prestigjioz për javën Evropiane të

mobilitetit për vitin 2013, në kryeqytetin e Sllovenisë, Ljubllanë.

Në Fushatën Java Evropiane e mobilitetit, në të cilën marrin pjesë mbi 1.900 qytete të Evropës janë bashkuar edhe Republika e Maqedonisë, qytetet Shkup, Manastir, Berovë, Strumicë dhe Veles. Janë mbajtur manifestime të shumta, punëtori edukative, ligjërime për promovimin e llojeve alternative të transportit. Këtë vit Delegacioni i BE-së në RM, në partneritet me Qytetin e Shkupit dhe Ministrinë e mjedisit jetësor organizuan paradë tradicionale me biçikleta, me çka Shkupi u është bashkuar qyteteve të Evropës. Qyteti i Shkupit promovoi aplikacion të ri që lehtëson qarkullimin rreth qytetit. Planifikuesi i rutës së gjelbër u siguron informata udhëtarëve gjatë planifikimit të rrugëve më të shpejta, më të lira dhe më ekologjike deri në destinacionin e tyre, duke përfshirë edhe të dhëna për qarkullimin e komunikacionit, dendësia e trafikut dhe emitimi i CO2.

<http://www.mobilityweek.eu/>

Polonia tejkaloi krizën ekonomike evropiane pa recesion me çka është dëshmuar se është e mundur rritje ekonomike pa pësuar rënie në disiplinën fiskale. Polonia edhe para

## DHJETË VITE NGA ANËTARËSIMI I POLONISË NË BASHKIMIN EVROPIAN

aderimit ka fituar përkrahje stabile evropiane pa recesion me çka dëshmoi se është e mundshme rritje e qëndrueshme ekonomike pa lëshim të disiplinës fiskale. Polonia edhe para anëtarësimit fitonte mbështetje dhe investime stabile ekonomike, sot shënon rritje të fuqishme ekonomike, zvogëlim të papunësisë, rritje të standardit jetësor dhe investimeve. Për Poloninë është posaçërisht e rëndësishme zgjedhja e kryeministrit Donalld Tusk, për kryetar të ri të Këshillit Evropian.

Sipas statistikave zyrtare, BPV i Polonisë për vitin 2013 ka qenë dy herë më i madh në krahasim me vitin 2003, përkatësisht nga 201 miliard është zmadhuar në 390 miliard euro. Rritja e ekonomisë nga viti 2003 ka arritur deri më 49% ndërsa mesatarja te vendet tjera anëtare në 10 vitet e kaluara ka qenë 11%. Sipas ekspertëve dhe analistëve ekzistojnë disa sqarime për arritjet ekonomike të Polonisë: Janë vendosur fundamente ekonomike të shëndosha përmes programit për transformimin ekonomik si dhe politikën e baraspeshës fiskale në dy dekadat e fundit. Polonia është shembull se si të kombinohet rritja dhe punësimi me disiplinë fiskale. Në vitin 2013 në vend BPV për banorë ka qenë më shumë se 2/3 nga përqindja e BE-së (68%), ndërsa dhjetë vjet paraprakisht ka qenë më pak se gjysma e përqindjes së BE-së (48,8%). Nga anëtarësimi në BE, në periudhën 2003-2013 shkalla e papunësisë nga 20% u zvogëluar në 13,4% ose në këtë periudhë janë punësuar rreth 800.000 njerëz. Rritja e punësisë nga 1,5 në 3,5% është falë shfrytëzimit të suksesshëm të fondeve evropiane.

Në Buxhetin e BE-së për vitin 2014 -2020, Polonia ka siguruar 82 miliard euro nga fondet strukturore ose ¼ nga të gjitha mjetet e dedikuara për politikën e konvergencës.

Harmonizimi i legjisllacionit të Polonisë me të

drejtën e BE-së kontribuoi që vendi të bëhet atraktivë për investitorët. Investimet e huaja direkte në vitin 2003 kanë qenë 50 miliard euro, ndërsa në vitin 2013 kanë arritur 125 miliard euro. Investimet në infrastrukturë kanë kontribuar për avancimin e kualitetit të jetës në Poloni. Me ndërtimin dhe modernizimin e rreth 700 stacioneve për pastrim sot sigurohet ujë i pastër në vende ku para dhjetë viteve ajo ka qenë e pamundur. Edhe krahas arritjeve pozitive, Polonia ende ka sfida veçanërisht me jobarazinë e regjioneve, disa prej tyre janë më të varfra në BE. Një pjesë e ndryshimeve të cilat u krijuan me anëtarësimin në BE nuk ishin pozitive për ekonominë e Polonisë, siç është për shembull direktiva për duhanin zbatimi i të cilës paraqet rrezik për industrinë e duhanit në Poloni, e cila punëson 50.000 njerëz dhe realizon të ardhura prej miliarda euro në buxhetin shtetëror. Rregullat e energjetikës dhe mbrojtja e mjedisit jetësor janë gjithashtu problematike, posaçërisht për shkak se qymyri edhe më tutje ngel burim i energjisë, dhe për këtë shkak Polonia i kundërshton qëllimet shumë ambicioze në luftën me ndryshime klimatike. Shteti disponon me resurse të dha dhe miniera të qymyrit, të cilat i shfrytëzojnë elektranat. Pjesëmarrja e Polonisë në burimet ripërtërisë të energjisë gradualisht rritet, rreth 12% nga energjia e shitur.

<http://stat.gov.pl/en/basic-data/>



*«Polonia shënon rritje të madhe ekonomike, zvogëlim të papunësisë dhe rritje të standardit jetësor dhe investimeve»*

## JAVA EVROPIANE E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME

Nga 25 shtator deri më 5 tetor të këtij viti, me ngjarje të shumta nacionale, rajonale dhe lokale në 37 shtet u shënuar Java Evropiane e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Iniciativa është e promovuar nga ana e Komisionit Evropian, në pajtim me aktin për biznese të vogla, e me qëllim që të sigurohen informacione për ofertuesit mundësi për

mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Në fokusin e kampanjës janë mundësitë për të rinjtë, promovimi i sipërmarrësisë, inovacioneve dhe konkurrencës.

[http://ec.europa.eu/enterprise/initiatives/sme-week/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/enterprise/initiatives/sme-week/index_en.htm)



## INTERES JASHTZAKONISHT I ZMADHUAR PËR PROGRAMIN PËR KËMBIM STUDENTOR - ERAZMUS



Komisioni Evropian në vitin 1987 e vendosi programin Erasmus, për nxitjen e mobilitetit të studentëve dhe kuadrit mësimor. Në programin Erasmus, për periudhën 2012/2013 kanë marrë pjesë rreth 270.000 studentë nga tërë Evropa, që deri tani paraqet rezultat më të mirë. Në program janë përfshirë të gjitha vendet-anëtare të BE-së, edhe Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia, Zvicra dhe Turqia.

Republika e Maqedonisë në Program është inkuadruar këtë vit.

Studentët Evropian kanë mundësi të studiojnë një vit në universitet përkatës jashtë vendit pa paguar taksë shkollore. Profesorët universitarë dhe kuadrit profesional nga arsimit i lartë mund të realizojnë qëndrim më së shumti deri 6 javë, me qëllim të studimit dhe përsosjes profesionale. Interes më të madh deri tani

është shprehur për studim në Spanjë, Gjermani dhe Francë, ndërsa për realizimin e punës praktike në Mbretërinë e Bashkuar. Për momentin rreth 10 % e studentëve evropian studiojnë ose janë në shkollim plotësues jashtë vendit, ndërsa supozohet se numri do të zmadhohet dyfish deri në vitin 2020.

Nga janari i këtij viti u vendos programi i zgjeruar "Erasmus plus" me të cilin në shtatë vitet e ardhshme do të ju jepet bursë rreth 4 miliona personave për studim, punë vullnetare dhe për përvojë pune jashtë vendit. Qëllimi i programit të ri është që të përmirësohet aftësitë, modernizimi i arsimit, aftësim dhe punësim i të rinjve. Për Erasmus plus për shtatë vitet e ardhshme janë paraparë 14.7 miliard euro ose 40% më shumë mjete se sa ato momentale.

[http://ec.europa.eu/education/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/education/index_en.htm)

[http://ec.europa.eu/news/culture/140819\\_en.htm](http://ec.europa.eu/news/culture/140819_en.htm)

## PARLAMENTET NACIONALE FTUAN MBROJTJE MË TË MADHE TË TË DHËNAVE PERSONALE



<http://ec.europa.eu/justice/data-protection>

Në deklaratën e përbashkët nga mbledhja e interparlamentare të mbajtur në Paris, delegacionet parlamentare nga 16 vendet-anëtare e ftuan Bashkimin Evropian për miratimin e legjislacionit për reformë të mbrojtjes së të dhënave personale deri në vitin 2014.

Pakoja legjislative e propozuar në janar 2012 përmban direktivë dhe rregullativë që u miratuan në Parlamentin Evropian, në lexim të parë në mars të këtij viti, para mbajtjes së zgjedhjeve evropiane.

Legjislacioni i propozuar përmban masa për mbrojtje të të dhënave personale të qytetarëve evropianë dhe kufizime të përdorimit të tyre nga ana e kompanive dhe shërbimeve të zbulimit. Çdo kompani e cila pa leje do të dërgojë të dhëna personale jashtë BE-së, do të ballafaqohet me dënim në para deri në 100 milion euro ose 5% nga qarkullimi i përgjithshëm. Kërkesat nga organet administrative ose gjyqësore të vendeve të treta, për qasje në të dhënat personale të

qytetarëve të BE-së me të cilat disponojnë kompanitë evropiane, do të jenë lëndë e kontrollit paraprak nga ana e agjencive nacionale për mbrojtje të të dhënave personale të vendeve-anëtare të BE-së.

Me këto masa, internet platforma Google dhe rrjeti social Facebook, para se të dërgojnë të dhëna nga shfrytëzuesit e tyre jashtë vendit, do të duhet të kërkojnë leje nga organet nacionale relevante.

Për pjesë të caktuara nga legjislacioni i propozuar ende zhvillohet debat i madh.

[EP Resolution on the proposal for a directive on the protection of individuals with regard to the processing of personal data/12 March 2014](http://www.euractiv.com/sections/infosociety/national-parliaments-raise-pressure-data-protection-308581)  
<http://www.euractiv.com/sections/infosociety/national-parliaments-raise-pressure-data-protection-308581>



## REPUBLIKA E MAQEDONISË U INKUADRUJA NË PROGRAMIN EVROPIAN PËR KONKURENCË - COSME

Më 29 shtator të këtij viti, ministri i Ekonomisë të Republikës së Maqedonisë dhe Komisari Evropian për Industri dhe Sipërmarrësi nënshkruan marrëveshje për përfshirjen e Republikës së Maqedonisë në Programin Evropian të konkurrencës të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme COSME.

Marrëveshje kanë nënshkruar edhe Moldavia, si vend i parë nga Partneriteti Lindor.

Programi Cosme e përfshinë periudhën nga 2014-2020 me buxhet prej 2.3 miliard euro. Qëllimet e programit janë: Promovimi i sipërmarrësisë dhe kulturës së sipërmarrësisë, përmirësimi i qasjen deri te tregjet e financimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe mbështetje e konkurrencës së ndërmarrjeve.

Republika e Maqedonisë është vendi i dytë

kandidat për anëtarësim në BE i cili përfshihet në programin COSME, pas Malit të Zi i cili u inkuadrua në qershor të këtij viti.

Pjesëmarrja e Republikës së Maqedonisë në Rrjetin Evropian për Sipërmarrësi (projekt i financuar nga COSME) me 28 vende-anëtare të BE-së paraqet tregues pozitiv për vazhdimin e procesit të fitimit të praktikave të shfrytëzueshme për sipërmarrësi, politikës për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe inovacionet në BE.

и иновативноста во ЕУ.

[http://ec.europa.eu/enterprise/initiatives/cosme/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/enterprise/initiatives/cosme/index_en.htm)  
[http://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-14-1052\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_IP-14-1052_en.htm)



### KALENDARI BE/tetor 2014

1. Dëgjimi i kandidatëve për komisarë në komitetet e Parlamentit Evropian, 29 shtator - 7 tetor 2014;
2. Miratimi i pakos për zgjerim 2014-strategjia dhe raportet vjetore të BE-së për progresin e arritur të vendeve nga procesi i zgjerimit, 8 tetor 2014.
3. Java evropiane e rajoneve dhe qyteteve 2014 6-9 tetor, Bruksel, Belgjikë;
4. Mbledhja e Këshillit për punë të përgjithshme të BE -së, 21 tetor 2014;
5. Mbledhja politike e Këshillit Evropian, 23-25 tetor 2014, Bruksel, Belgjikë;
6. Sesioni Plenar i Parlamentit Evropian, 20-23 tetor 2014, Strasburg, Francë

<http://europa.eu/newsroom/calendar/>

The screenshot shows the 'European Union Newsroom' website. The main navigation bar includes 'Home', 'Highlights', 'Press releases', 'Calendar', 'Audiovisual', 'Press contacts', 'Press facilities', and 'About the EU'. The 'CALENDAR' section is active, displaying a 'BROWSE FORTHCOMING EVENTS' filter and a 'BY MONTH' calendar for July 2014. The calendar grid shows dates from 1 to 31. Below the calendar, there are filters for 'By topic', 'By organiser', and 'By type'. A list of 'All forthcoming events' is shown, with the first event being 'ESA-JRC International Summer School on GNSS 2014' on 21-31 July. There is also a 'Help us improve' section with a feedback form.



## KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

### BE QENDRA E KUVENDIT

Adresa: 11 Tetori nr. 10, Shkup, 1000

telefoni: +389 2 3 11 22 55, lokali 414 dhe 289

fax +389 2 3 182 277

E-mail: [nsei@sobranie.mk](mailto:nsei@sobranie.mk)

zyra 019

---

[www.sobranie.mk](http://www.sobranie.mk)

---

*Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në periudhën janar 2011-qershor 2012 u realizua Projekti IPA për "Ndhimë teknike për Parlamentin", qëllimi i përgjithshëm i të cilit ishte përforcimi i kapacitetit institucional të Kuvendit dhe me atë përmirësimi i transparencës dhe përgjegjësisë së tij para qytetarëve.*

*Në kuadër të projektit IPA, u sigurua ndihmë financiare dhe profesionale për vendosjen e BE qendrës në Kuvend.*

*Qëllimi i formimit të BE qendrës është që deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe Shërbimit të Kuvendit t'u sigurohet qasje më e mirë në informatat lidhur me çështjet e BE-së.*

